

Управата за јавни приходи по утврдување на постоење на долг по основ на неисплатена плата, придонеси од задолжително социјално осигурување и даноци за два последователни месеци, за работодавач - корисник на мерката од членот 98-з став 1 од овој закон, ќе започне постапка за наплата на износот на средствата за кои работодавачот бил ослободен од плаќање согласно закон, а на работодавачот му престанува ослободувањето од плаќање придонеси од задолжително социјално осигурување согласно мерката од став 1 на овој член.”

#### Член 2

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собраните на Република Македонија да утврди пречистен текст на Законот за вработувањето и осигурување во случај на невработеност.

#### Член 3

Овој закон влегува во сила со денот на објавување то во „Службен весник на Република Македонија“.

## L I G J PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PUNËSIM DHE SIGURIM NË RAST TË PAPANËSISË

#### Neni 1

Në Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 3719/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003, 37/2004, 4/2005, 50/2006, 29/2007, 102/2008, 161/2008, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12, 114/12, 39/14, 44/14, 113/14, 56/15, 129/15 dhe 147/15), pas nenit 98-z shtohen dy nene të reja 98-z dhe 98-x, si vijojnë:

#### "Neni 98-z

Punëdhënësi nga sektori privat, pas kërkesës së parashtruar paraprkishtë te Agjencia, do të lirohet nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social për personin që do ta punësojë si zëvendësim për punëtorin që shfrytëzon pushim të lindjes nga puna, për periudhën derisa zgjatë pushimi i lindjes.

Punëdhënësi nga sektori privat që ta shfrytëzojë masën nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk guxon të ketë rroga të paraguara, kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social dhe tatime më tepër se dy muaj të njëpasnjëshëm, që dëshmohet me vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Publike nga punëdhënësi apo në formë të shkëmbimit të të dhënave me detyrë zyrtare përmes Agjencisë.

Punëdhënësi detyrohet pas kalimit të pushimit të lindjes së punëtorit dhe kthimit të tij në punë, ta mbajë të njëjtin në punë edhe më pak për periudhën e njëjtë për të cilën është liruar nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me masën nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç në rast kur punëdhënësi me deklaratë të verifikuar në noter do të deklarojë se nuk do të kthehet në vendin e punës.

Punëtori për të cilin shfrytëzohet lirimi në pajtim me masën nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të punojë në vendin e njëjtë të punës në të cilën ka punuar punëtori që shfrytëzon pushim të lindjes, dhe t'i paguhet rroga e njëjtë

neto, në të kundërtën punëdhënësi detyrohet ta kthejë shumën e mjeteve për të cilën është liruar nga pagesa për periudhën e kaluar në pajtim me masën nga paragrafi 1 i këtij neni.

Punëdhënësi që nuk mund ta mbajë punëtori pas kalimit të pushimit të tij të lindjes dhe kthimi i tij në punë për edhe më pak të periudhës së njëjtë për të cilën është liruar nga pagesën e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me masën nga paragrafi 1 i këtij neni, detyrohet në afat prej 30 ditësh të arkëtojë dy herë shumë më të madhe se shumata e mjeteve për të cilën është liruar nga pagesa për periudhën e kaluar.

Shfrytëzimi i masës nga paragrafi 1 i këtij neni do të pushojë nëse punëdhënësi i cili pas punësimit të personit si zëvendësim për punëtor që shfrytëzon pushim të lindjes nga puna, për periudhën derisa zgjatë pushimi i lindjes, ka borxh në bazë të rrogës së papaguar, kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social dhe tatimeve për dy muaj të njëpasnjëshëm, dhe i njëjti detyrohet ta arkëtojë shumën e mjeteve për të cilën është liruar nga pagesa për periudhën e kaluar në pajtim me masën nga paragrafi 1 i këtij neni.

#### Neni 98-x

Agjencia më së voni çdo 30 ditë do të dorëzojë të dhëna te Drejtoria e të Ardhurave Publike për punëdhënësit nga sektori privat - shfrytëzues të masës nga neni 98-z paragrafi 1 i këtij ligji, me qëllim Drejtoria e të Ardhurave Publike të merr pasa në pajtim me kompetencat ligjore.

Drejtoria e të Ardhurave Publike pas përcaktimit të ekzistimit të borxhit në bazë të rrogës së papaguar, kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social dhe tatimeve për dy muaj të njëpasnjëshëm, për punëdhënësin - shfrytëzues të masës nga neni 98-z paragrafi 1 të këtij ligji, do të fillojë procedura për arkëtimin e shumës së mjeteve për të cilat punëdhënësi ishte liruar nga pagesa në pajtim me ligjin, kurse punëdhënësi i pushon lirimi nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me masën nga paragrafi 1 i këtij neni."

#### Neni 2

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë.

#### Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

### 4456.

Vrz основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

## У К А З ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА АДМИНИСТРАТИВНИ СЛУЖБЕНИЦИ

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за административни службеници,